



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja nr. 39
Prishtinë, më 26.01. 2010 në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës
Salla nr. N- 225

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Drita Kadriu, Donika Kadaj -Bujupi, Mark Krasniqi, Haset Cakolli dhe Dragan Dimiq.

Munguan: Arsim Rexhepi, Enis Kervan dhe Memli Krasniqi.

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu.

Në mbledhje prezantuan: përfaqësuesi i OSBE - së, i NDI - së, përfaqësuesi nga Presidenca dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Mbledhjen e udhëhoqi: Drita Kadriu zv. kryesuese e parë e Komisionit.

Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 19 janar 2010,
3. Shqyrtimi i Raportit të Punës së Komisionit për vitin 2009;
4. Shqyrtimi i Planit të Punës së Komisionit për vitin 2010.
5. Shqyrtimi i Planit të Veprimit të Kuvendit për Integritet Evropian.

Kryesuesja , konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes.

1. Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 19.01.2010

Kryesuesja konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së datës 19.01.2010 pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit për vitin 2009

Kryesuesja tha se përmes këtij raporti, është pasqyrohet puna dhe aktivitetet që ka realizuar Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport gjatë periudhës janar – dhjetor 2009, që është në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë që i ka të përcaktuara me Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Heset Cakolli lidhur me këtë pikë tha se në bazë të Raportit Komisioni ka realizuar me sukses detyrat dhe përgjegjësitë që i takojnë. Meqë në vitin 2009 nuk është realizuar asnjë vizitë e Komisionit jashtë vendit shpreson që këtë vit të realizohen vizita me karakter pune jashtë vendit.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

PËRFUNDIM

Miratohet Raporti i punës së Komisionit për periudhën për vitin 2009.

4. Shqyrtimi i Planit të Punës së Komisionit për vitin 2010.

Kryesuesja tha se plani i punës së Komisionit është bazuar sipas Strategjisë Legjislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2010. Ky plan i punës që pasqyron aktivitetin gjithë përfshirës sipas kompetencës për periudhën janar- dhjetor 2010.

Komisioni gjatë vitit 2010 aktivitet kryesor do të këtë shqyrtimin dhe miratimin projektligjeve, mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjeve, monitorimin e resorëve të Qeverisë që bien në kompetencë e Komisionit.

Në bazë të politikave të strategjisë legjislative të përcaktuara nga programi i punës së Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe të Ministrisë së Kulturës, Rinisë e Sportit për këtë vit janë paraparë gjithsejtë nëntë projektligje prej tyre gjashtë nga Ministria e Kulturës dhe tre nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Sa i përket projektligjeve nga fusha e arsimit mendon se do të ishte me rëndësi që plotësimi dhe ndryshimi i projektligjeve nga kjo fushë të procedohen në një kohë më të afërt se që është paraparë në Strategjinë Legjislative të Qeverisë.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

PËRFUNDIM

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport miratoi plan punës së vet, për periudhën janar- dhjetor 2010.

5. Shqyrtimi i Planit të Veprimit të Kuvendit për Integrime Evropiane.

Kryesuesja, lidhur me këtë pikë i njoftoi anëtarët e Komisionit se Plani i Veprimit për Integrime Evropiane ka për qëllim përmbushjen e aktiviteteve të parapara nga Komisioni për periudhën e caktuar.

Aktivitetet e Planit të Veprimit janë paraparë të shqyrtohen nga Komisioni në tremujorin e parë të vitit dhe së bashku me Komisionet tjera të mbajë dëgjime publike dhe të përgatiten raporte me Rekomandime për Kuvend.

Heset Cakolli vlerëson që për këtë qëllim duhet të bëhen vizita të Komisionit në terren me qëllim të marrjes së informacioneve më të sakta lidhur me përpushjen e planit të veprimit për Integrime Evropiane.

Kryesuesja konstatoi se Komisioni me shumicë votash nxori këtë:

PËRFUNDIM

Miratohet Plani i Veprimit i Kuvendit për Integrime Evropiane.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 11: 50

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryesuesja e Komisionit,

Drita Kadriu